

URDHËR
Nr. 68, datë 24.1.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për procedurat e prokurimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sekretarit të Përgjithshëm z. Enea Hoti.
2. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.
4. Urdhri nr. 1, datë 5.1.2018, shfuqizohet.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi